



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më: 20.11. 2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë, Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Anton Quni, Qerim Bajrami, Ganimete Musliu dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës nga institucionet: **Shkëlzen Syla**, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e FSK-së, **Drita Xheladini**, drejtoreshë e Buxhetit dhe Financave- Ministria e Punëve të Brendshme, **Bekim Demiri** -Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **Mexhid Dragusha**- Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit në Policinë e Kosovës, **Esat Hasolli**- Udhëheqës i Financave në IPK, **Ismail Smakiqi**- Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi-DCAF.

Mbledhjen e kryesoi Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit të datës 4.11.2015;
3. Shqyrtimi i Projekt-buxhetit për sektorin e sigurisë, për vitin 2016;

4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e komisionit të datës 4.11.2015;

Procesverbali do të miratohet në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Projekt-buxhetit për Sektorin e Sigurisë për vitin 2016;

Kryesuesi theksoi, që pasi jemi Komision mbikëqyrës për institucionet e sigurisë, kemi ftuar përfaqësuesit e këtyre institucioneve për të kuptuar nevojat buxhetore të tyre, pasi në mes të dy leximeve të Projektligjit për Buxhetin, si Komision mund të bashkëpunojmë me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës. Tutje fjalën ia kaloi përfaqësuesit nga Ministria e FSK-së

Shkelzen Syla, sekretar i përgjithshëm në MFSK, bëri prezantimin e të gjitha planifikimeve të FSK-së dhe Ministrinë e FSK-së për vitin 2016. Ai theksoi se ky planifikim ka rrjedhur sipas fazave të planifikuara nga Ministria e FSK-së, sipas projektit FACIS, që është sipas standardeve të NATO-s, në kuadër të së cilës parashihen pajisjet individuale dhe kolektive dhe nevojat e tjera, me qëllim të përmbushjes së misionit për FSK-në, që dalin nga ligjet aktuale. Në kuadër të këtij projekti është edhe tabela organizative e pajisjeve, e cila është e përpunuar mirë me mbështetjen e ekspertëve nga ShBA-ja, të cilët vijnë në mënyrë periodike në Ministrinë e FSK-së. Deri më tani kemi arritur të zhvillojmë edhe planin afatmesëm dhe afatgjatë zhvillimor dhjetëvjeçar, në kuadër të të cilit janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura, me qëllim të arrihet përmbushja e misionit.

Në kuadër të planifikimeve që janë bërë për buxhetin e vitit 2016, për Ministrinë e Forcës, dhe për FSK-në, sipas kategorive të planifikuara, është e miratuar nga Qeveria totali i buxhetit për vitin 2016, që është 49 milionë e 250 mijë euro. Kërkesat buxhetore sipas planit afatgjatë zhvillimor, afatmesëm zhvillimor dhe sipas planit vjetor të buxhetit, kanë qenë me të larta dhe sipas deklaratës financiare, në rast të miratimit të ligjeve për FAK-un, do të ketë nevojë për buxhet shtesë, me qëllim të përmbushjes së nevojave që janë planifikuara. Tutje theksoi se buxheti i vitit 2016, në krahasim me buxhetin e vitit 2015, është 9 % më i lartë.

Në buxhetin e planifikuar për vitin 2016, është ndarja në disa kategori, si në vijim: Në linjën e pagave dhe mëditjeve, vlera e buxhetit të planifikuar është 44% e totalit të buxhetit të planifikuar, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 18% e totalit të buxhetit, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve komunale, vlera e buxhetit të planifikuar për vitin 2016 është 1.60% e buxhetit, ndërsa në linjën për shpenzime kapitale, që ka ngritje të buxhetit për këtë vit, vlera e planifikuar është 36% e buxhetit të planifikuar. Buxheti i dërguar për miratim në Kuvend, edhe pse është rritur për 9% të vlerës totale sipas planit afatgjatë zhvillimor dhe në rast se miratohen

projektligjet e rekomanduara nga Qeveria nuk do të plotësojnë nevojat e planifikuara. Me nënshkrimin e deklaratës financiare nga ministri i Financave, presim që pas marrjes së vendimit dhe pas krijimit të kushteve për implementim të ligjeve të reja, të ketë buxhet shtesë për plotësimin e nevojave, theksoi Shkëlzen Syla.

Anton Quni, duke iu referuar shpjegimit nga ana e z.Syla për buxhetin e Ministrisë së FSK-së, shtroi pyetjen se a kanë përllogaritje, se sa do të jetë kostoja shtesë pas transformimit të FSK-së në FAK, dhe sa do të jenë të gatshme institucionet e Qeverisë së Kosovës, t'ju mbështesin në këtë aspekt?

Shkëlzen Syla- Sipas planifikimeve të bëra në planin afatgjatë zhvillimor të Forcave të Armatosura të Kosovës, ne kemi të kalkuluar çdo vit buxhetor sa duhet të jetë buxheti për t'i plotësuar nevojat elementare të Forcës, me qëllim të implementimit të planit afatgjatë zhvillimor. Nga kjo del që ne e kemi edhe të nënshkruar deklaratën financiare nga ministri i Financave, që duke filluar nga viti 2016, vlera duhet të jetë 54 milionë euro, për vitin 2017 duhet të jetë 62 milionë e 64 mijë euro, ndërsa për vitin 2018 duhet të jetë 67 milionë e 964 euro. Do të thotë, se është e planifikuar kjo skemë sipas planit afatgjatë për të gjitha vitet deri në vitin 2025 dhe që totali i planifikuar për këtë zhvillim është i përshkruar në detaje për secilin vit. Kjo është arritur edhe me mbështetjen e këshilltarëve që mbështesin Ministrinë e FSK-së, siç është Ekipi Këshillues i NATO-s.

Kryesuesi, shtoi se nga prezantimi, e gjithë ajo që është planifikuar nga Ministria e FSK-së është e përfshirë në buxhetin e vitit 2016.

Nuredin Ibishi- Vlerësoi që me qëllim të planifikimit sa më të mirë të bashkëpunojmë paraprakisht me ju, dhe si Komision mund të llobojmë në këtë drejtim dhe është mirë që buxheti i planifikuar është në drejtim të zbatimit të planit afatgjatë dhjetëvjeçar.

Shkëlzen Syla, tha se të gjitha kërkesat e Ministrisë së FSK-së janë të prezantuara në kohë dhe presim që në moment të miratimit të ligjeve të FSK-së, konform deklaratës financiare, Qeveria e Kosovës të përkrahë Ministrinë e FSK-së në përmbushjen detyrave dhe misionit.

Anton Quni- Referuar Raportit të progresit për vitin 2015, është bërë vërejtje që disa nga anëtarët e Komisionit, duke qenë ish-pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, në raport me FSK-në dhe institucionet që i mbikëqyrin, kemi qenë subjektiv, kjo për shkak të raporteve kolegjiale. Tutje, tha që pajtohet me këtë vlerësim, pasi në disa situata është "shikuar ndërmjet gishtave", kjo nuk duhet të merret si kërcënim por në këtë mandat Komisioni do të jetë më i përkushtuar në mbikëqyrjen e ligjeve që ju i zbatoni dhe fondeve të dedikuara për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Shkëlzen Syla- Vlerësoi se anëtarët e Komisionit me profesionalizmin dhe përkrahjen e tyre i kanë ndihmuar zhvillimit të FSK-së dhe është udhërrëfyes për planifikime dhe në të ardhmen presim kritikën dhe bashkëpunimin e Komisionit.

Drita Xheladini, drejtoreshë e Buxhetit dhe Financave-Ministria e Punëve të Brendshme, theksoi se Buxheti që është aprovuar në Qeveri për MPB-në është i zvogëluar për 5.59 për qind, do të thotë është shkurtuar në paga dhe mallra dhe shërbime. Kështu që, buxheti i përgjithshëm

për MPB-në është 109 milionë, e 123 mijë euro. Ndërsa kërkesat shtesë me vlerësimet që kemi bërë pas dëgjimeve buxhetore me Ministrinë e Financave janë 31 milionë e 614 mijë euro, buxhet shtesë që është kërkuar duke e arsyetuar në bazë të misioneve dhe aktiviteteve të Ministrisë. Kërkesat shtesë që janë të domosdoshme e kanë ngritur këtë shumë të kërkesave shtesë që nuk ka mundur të hyjë në buxhetin e vlerësuar, janë të PK-ja, uniforma për PK-në dhe janë kërkesa shtesë tek ligji për përgjimet e PK-së. Sa i përket niveli të përgjithshëm të MPB-së, kërkesat shtesë që janë bërë në operativë që nuk kanë mundur të përfshihen në buxhetin e aprovuar nga Qeveria, janë kërkesa për sistemet e mirëmbajtjes në Akademinë Policore të Kosovës dhe në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Një pjesë e mirëmbajtje së sistemeve janë në mirëmbajtje nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa nga viti i ardhshëm do të kalojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për këtë çështje nuk ka buxhet të mjaftueshëm. Gjithashtu është kërkuar buxhet shtesë për pajisjen me dokumente blanko për vitin e ardhshëm.

Mexhid Dragusha, udhëheqës i Divizionit të Buxhetit në Policinë e Kosovës, theksoi se kërkesat shtesë që kanë pasur janë detyruar që të përgjysmojnë vlerën, normalisht që kjo do të ndikojë në vështirësi në arritjen e objektivave të Policisë së Kosovës. Mirëpo, pos kësaj, shqetësuese për PK-në është edhe zbritja që i është bërë brenda kornizës për mallra dhe shërbime diku mbi 1 milion, që ndikon në projektin e uniformave. Do të kisha kërkuar nga Komisioni që ky buxhet i PK-së të ngritet. Kërkesat e Policisë së Kosovës ashtu siç u përmendën edhe më herët janë mbështetur në procese, siç është ngritja e kapaciteteve dhe upgrade i sistemit të përgjimit ligjor, furnizimi me uniforma, çështja e rinimit të Policisë së Kosovës dhe për këtë çështje është duke u punuar në Ligjin për Pensionimin e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, Drejtorinë për Mbrojtjen Dëshmitarëve, e cila për tu operacionalizuar duhet buxhet shtesë. Gjithashtu Policia e Kosovës ka bashkëpunim në aspektin ndërkombëtar, ku për këtë qëllim janë caktuar zyrtarë ndërlidhës dhe atashe policorë në disa shtete, si dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, siç janë: Interpoli, EUROPOLI, etj., të cilat kanë implikime buxhetore.

Ismail Smakiqi, drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, theksoi se Akademia i ka të stabilizuara trajnimet bazike dhe para Komisionit do të kërkoja që me zhvillimet strategjike që varen nga Kuvendi i Kosovës dhe siç është Projektligji për Pensionimin e Pjesëtarëve të PK-së, mund të ketë implikime buxhetore, pasi nga ana e Akademisë duhet trajnimi i gjeneratave të reja. Akademia ka Fakultetin e Sigurisë Publike si rezultat i projektit të binjakëzimit me Komisionin Evropian, dhe të gjitha agjencitë e sigurisë publike tashmë kanë studentë në Akademi. Gjithashtu sa i përket nevojave të zhvillimit arsimor, do të kemi nevojë në të ardhmen për një objekt me standarde më të larta.

Po ashtu, Smakiqi njoftoi që Banka Botërore e ka futur në projekt për të bërë meremetimin e Akademisë, ndërsa sa i përket rritjes së numrit të trajnimeve e cila është kërkesë e një sërë raportesh ndërkombëtare, për këtë janë disa agjenci të cilat bëjnë trajnime të vazhdueshme dhe se trajnimet planifikohen në fillim të çdo viti me agjenci. Po ashtu, ai theksoi se Policia e Kosovës ka nevojë për rritje të trajnimeve deri në 30%, dhe kjo e shton automatikisht nevojën për mallra dhe shërbime dhe duke marrë në konsideratë që buxheti për vitin 2016, është shkurtuar do të kemi vështirësi në këtë drejtim.

Esat Hasolli, udhëheqës i Financave në IPK-së, theksoi se IPK-ja është në fazën e shtrirjes në regjione dhe për këtë qëllim i nevojitet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike të IPK-së. Buxheti i alokuar për IPK-në, nuk do të mjaftojë në realizimin me sukses të misionit si dhe objektivave të saj. Bazuar në rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe

Mbikëqyrje të FSK-së si dhe të Këshillit të Evropës, për regionalizim të IPK-së, IPK-ja ka filluar shtrirjen e saj në vend. Deri tani janë hapur dy zyra regjionale (Gjilan dhe Prizren) dhe jemi në përpjeke për hapjen e zyrës së tretë edhe në veri të vendit. Për të realizuar projektligjin e shtrirjes së IPK-së nevojite edhe 414 mijë euro shtesë, përfshirë të gjitha kategoritë buxhetore.

Shqetësim tjetër që ka IPK-ja është edhe tkurrja e shumë buxhetore në kategorinë e projekteve kapitale dhe për këtë do të kërkohet përkrahja për rritjen e këtij kufiri.

Nuredin Ibishi, theksoi se në kuadër të mbikëqyrjes së Ligjit të Policisë, është ngritur edhe çështja e buxhetit për vitin 2016, siç është edhe rasti për pensionimin e parakohshëm të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, i cili në pamundësi buxhetore do të miratohet në vitin 2017. Çështja tjetër është aspekti legal, që të gjitha udhëzimet administrative të përgatiten, po ashtu projekti për policinë rezervë nuk është realizuar dhe edhe për këtë do të ketë nevojë për buxhet shtesë. Gjithashtu emergjencat kanë ngecje në realizimin e projekteve në aspektin e realizimit të menaxhimit të integruar të emergjencave. Ibishi propozoi që para se të bëhet rishqyrtimi i buxhetit në gjashtëmujorin e dytë të shikohet aspekti i investimeve kapitale.

Ganimete Musliu, tha se do të donte një sqarim më të detajuar sa i përket buxhetit shtesë për IPK-në në të gjitha kategoritë. Për këtë arsye propozoi që me që jemi në fazën e amendamentimit të ligjit, mund të ndihmojmë në këtë aspekt. Për këtë arsye kërkoi sqarim shtesë lidhur me këtë çështje, se për çfarë duhet buxhet shtesë? Kërkesa për një buxhet të tillë, nuk është bërë me kohë apo është reduktuar buxheti?

Esat Hasolli - Në përgjigje të znj. Ganimete Musliu, tha që aktualisht IPK-ja funksionon me 75 zyrtarë, ndërsa të punësuar janë 72. Për të arritur misionin dhe regionalizimin në nivel vendi, nevojiten edhe 17 pozita të reja. Kërkesat buxhetore janë paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe se përgjigjja është kthyer gjithmonë negative.

Anton Quni, theksoi se në mandatin e kaluar është bërë mbikëqyrja e shpenzimeve financiare nga ana e MPB-së dhe PK-së. Nga grupi punues kanë dalë të gjeturat dhe keqpërdorime. Pasi nuk kemi marrë informatë kthyesë, se çfarë kanë bërë zyrtarët e MPB-së dhe PK-së, që të gjitha këto keqpërdorime të anulohen dhe të ndërmerren masa ndaj atyre që kanë bërë keqpërdorime. Për këtë arsye theksoi që mandatin që ka Komisioni do të shtrijë në mbikëqyrjen e financave si dhe legjislacionit të institucioneve që janë në kuadër të fushëveprimtarisë së Komisionit.

Kryesuesi shtroi pyetje për përfaqësuesen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me tri gjenerata të kadetëve që kanë shkuar në Turqi, në bazë të marrëveshjes së arritur nga vet Ministria. Pas përfundimit të Akademisë në Turqi, marrëveshja ka qenë që të bëhet sistemimi i tyre, ndërsa kanë kaluar 5 vite dhe nuk është realizuar ky projekt nga Ministria. A është paraparë në buxhetin për vitin 2016, sistemimi i këtyre kadetëve?

Drita Xheladini, drejtoreshë e Buxhetit dhe Financave- Në përgjigjeje të pyetjes së z. Fadil Demaku, tha se marrëveshja për këtë çështje është nënshkruar në vitin 2008 dhe marrëveshja ka qenë që pas përfundimit të këtij shkollimi të inkuadrohen në Policinë e Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur dhe për këtë çështje nuk kemi kërkesë buxhetore që është paraparë inkuadrimi i tyre në kuadër të MPB-së. Nga ana e MPB-së është ndarë bursë për të, në shumën 150 euro dhe buxheti ka qenë i Policisë së Kosovës. Tani janë edhe dy kadet që janë duke e vazhduar shkollimin në Turqi.

Ndërsa sa i përket emergjencave, MPB-së i është shkurtuar buxheti për 2 (dy) milion euro, për shkak të inkuadrimin të pjesëtarëve të komunitet serb në veri të Mitrovicës, ku ky buxhet është marrë nga mallrat dhe shërbimet, duke e alokuar për projekte për veriu të Mitrovicës.

Bekim Demiri, anëtar i Këshillit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, theksoi se që nga fillimi kur është themeluar Agjencia, ka pasur mungesë të buxhetit, por në mbështetjen e fondeve të IPA-s nga Komisioni Evropian është evituar ky boshllëk. Projekti i IPA-as përfundo në këtë vit, ndërsa vitin që vjen nuk do të ketë fondet e tilla. Bazuar në raportet e progresit të përgatitura ndër vite, kanë qenë pozitive, ndërsa sa i përket Raportit të Progresit të vitit 2015, evidentohet nevoja për mbështetje financiare dhe kapacitete njerëzore. Agjencia është anëtarësuar në të gjithë organizmat regjionalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Demiri tha se është bërë kërkesë në Zyrën e BE-së në Kosovë për të vazhduar projektin në mbështetje të agjencisë të paktën edhe për disa muaj, prandaj vlerësojmë që nevoja për mbështetje financiare e Agjencisë është e nevojshme për të arritur dhe realizuar objektivat e përcaktuara. Ai theksoi se ka mundësi edhe për donacione nga kompani private, por që një gjë e tillë nuk është e preferuar.

Kryesuesi, theksoi që Komisioni e vlerëson rolin dhe sfidat e Agjencisë në realizimin objektivave. Po ashtu, theksoi se sa i përket donacioneve private, kjo nuk duhet të lejohet, ndërsa Komisioni do të angazhohet në adresimin e kërkesave të Agjencisë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Qerim Bajrami, lidhur me kërkesën dhe nevojën për buxhet nga ana e Agjencisë, vlerësoi se nga Komisioni mund të bëhet një kërkesë me shkrim lidhur me këtë çështje. Po ashtu theksoi se në një nga takimet e realizuara, ka ngritur çështjen e mospunësimit të pjesëtarëve të komunitetit boshnjak në këtë Agjenci, kjo jo vetëm për përfaqësimin e këtij komuniteti, por për shkak të nevojave që të ofrohet shërbim adekuat edhe për qytetarët e komunitetit boshnjak.

Bekim Demiri, tha se kërkesat e dërguara për buxhet të njoftuar (CC), ka qenë Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Siguri. Ndërsa s ai përket përfaqësimit të komunitetit boshnjak, tha se përveç z.Aleksandër Spasiq, nuk ka të tjerë nga komuniteti boshnjak. Po ashtu theksoi se pas konkursit, i cili është shpallur, ka pasur mungesë të kuadrove nga ky komunitet. Mungesa e fondeve mundohet të mbulohet në disa raste me edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të ndryshme.

Qerim Bajrami, njoftoi lidhur me vizitën e realizuar nga ana e Komisionit në stacionin Policor të Prizrenit, e cila ka qenë e suksesshme dhe kjo ka pasur një efekt tek qytetarët dhe tek stacionet policore të këtij rajoni. Po ashtu, ky vlerësoi se vizitat në terren janë pozitive dhe se nëse do të ishte e mundur të realizohet edhe vizita në veri të Kosovës, dhe nëse do të vizitohet Leposaviqi, propozoi të vizitohet një fshat i banuar nga komuniteti boshnjak, Rvacka.

Nuredin Ibishi, theksoi se sa i përket përmbylljes së mbikëqyrjes së Ligjit për Policinë e Kosovës, është në përgatitje e sipër raporti përfundimtar, ndërsa s ai përket vizitës në veri të vendit, edhe pse ka qenë e planifikuar nga sponzoruesi, që në këtë rast është OSCE-ja, është paraqitur rezerva duke realizuar një vizitë në jug dhe ku do të ftoheshin përfaqësuesit e veriut. Tani është çështja e Komisionit, i cili mund të marrë vendim për këtë çështje, në mënyrë që të realizojë këtë vizitë ose jo.

Kryesuesi, theksoi ë vizita duhet të realizohet ashtu siç është paraparë dhe jo duke e plotësuar dhe zhvendosur diku tjetër.

Bojan Mitiq- Kanë qenë disa vizita të realizuara, ndërsa unë nuk kam qenë i njoftuar për to. Ndërsa sa i përket vizitës në veri të Kosovës, do të jap maksimumin që kjo vizitë të realizohet

dhe besoj që kur do të arrijmë të realizojmë nuk do të kemi ndonjë problem. Ndërsa sa i përket vizitës së realizuar nuk kam marrë asnjë njoftim

Qerim Bajrami, tha se kanë qenë në katër vizita në stacionet policore në rajonin e Prizrenit, ndërsa një ka qenë në Sredskë.

Fadil Demaku, theksoi se vizitat e tilla janë realizuar nga ana e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit për Policinë e Kosovës, dhe po ashtu, propozoi që si Komision mund të realizohen vizita të tilla.

Nuredin Ibishi, tha se në vizitën në Stacionin Policor të Sredskës, ka qenë i ftuar i gjithë komisioni, ndërsa është tjetër nëse nuk janë informuar me kohë. Ndërsa sa i përket pjesës veriore, theksoi se duhet të vizitohet për të parë se si aplikohet Ligji për Policinë e Kosovës.

Fadil Demaku, propozoi që në mbledhjen e radhës mund të diskutohet lidhur me realizimin e një vizite në veri të vendit.

Bojan Mitiq, theksoi se njoftimin për të marrë pjesë në këtë vizitë nuk e ka marrë, dhe nuk e kam ditur që katër vizitat kanë ndodhur brenda ditës.

Fadil Demaku- Kërkoj falje nëse nuk është arritur që të informohet z.Mitiq me kohë. Tutje fjalën ia kaloi znj.Luanda Domi nga DCAF-i.

Luanda Domi, njoftoi për Konferencën Rajonale Parlamentare të Evropës Juglindore mbi menaxhimin e refugjatëve dhe migracionit, e cila është zhvillohet në bashkëorganizimi me DACAF-in dhe Parlamentit të Serbisë dhe kërkoi që të përcaktohet edhe një përfaqësues pasi dy që ishin përcaktuar janë tërhequr.

Kryesuesi, propozoi z.Qerim Bajrami të marrë pjesë në këtë Konferencë.

Qerim Bajrami, tha se e pranon propozimin që të marrë pjesë, por që nuk ka pasur sqarim se cilat parlamente marrin pjesë. Po ashtu theksoi se ka një vizitë në Bruksel me datë 1 dhjetor 2015.

Bojan Mitiq- E kam dhënë shpjegimin tim përmes Mersiha Hallaçit, pasi kam për të marrë pjesë në Seminarin në Kopaonik 27, dhe arsyeja që e kam anuluar pjesëmarrjen në Konferencën në Beograd, pasi këtë e kam konfirmuar më herët.

Kryesuesi, me këtë pikë të rendit të ditës e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku